



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 10257 prot.

Elbasan, më 29 .2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË QARKUT ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr. 36 dt.10.09.2025 "Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Librazhd 2025-2029", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





1025
11.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

Nr 330 Prot

Elbasan më, 11 .09.2025

VENDIM

Nr 36, datë 10 .09.2025

“PËR MIRATIMIN E “PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË LIBRAZHD, 2025-2029”

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 13, pika 7, amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013,
- Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”,
- Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”,
- Ligji Nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për kundravajtjet administrative”,
- VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”,
- Rregulloren Nr.1 datë 30.03.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim”
- Udhezimit Nr. 6, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave “Për miratimin e rregullave përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”,
- Strategjia Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.
- Miratimin e aktit nga Prefekti Qarkut Elbasan me Nr.86611 prot, datë 11.08.2025 për konfirmimin në parim të mbështetjes në ligj të “VKB Nr.63, datë 29.07.2025 “Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve në Bashkisë Librazhd”.
- VKB Nr.63 datë 29.07.2025 “Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve Bashkia Librazhd”,
- Shkresës Nr.5455/1 prot datë 25.08.2025 të Bashkisë Librazhd “Dergim informacioni”,

me propozim të Grupit të Menaxhimit Strategjik, Këshilli i Qarkut Elbasan në mbledhjen e datës 10 .09.2025:

VENDOSI:

1.Të miratojë “Planin Vendor për Administrimin dhe Menaxhimin e Mbetjeve” për vitin 2025-2029, në Bashkinë Librazhd”, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

